



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 190

Tiranë – E enjte, 5 nëntor 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 30.10.2015	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF018931, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), në kuadër të fondit të mirëbesimit SECO, për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri.....	12715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 30.10.2015	Për miratimin e marrëveshjes së Grantit nr. TF014999, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI).....	12718
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 871, datë 30.10.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 590, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e banesave të personaliteteve të larta shtetërore të vendit, të selive, rezidencave dhe objekteve të tjera shtetërore, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	12742
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 30.10.2015	Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2016, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.....	12742
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 30.10.2015	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Rozafa” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Objekte të Agjencisë së Rezervave të Shtetit, Labinot, Elbasan”, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.....	12742

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 30.10.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 592, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e fondit në mbështetje të grave sipërmarrëse”.....	12743
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 875, datë 30.10.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 593, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e fondit në mbështetje të sipërmarrjeve të reja “Start-Up””.....	12743
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 30.10.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 758, datë 15.9.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës dhe kritereve për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, si dhe masën e shpërblimit të tyre”.....	12744



VENDIM

Nr. 869, datë 30.10.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF018931, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA QEVERIA E KONFEDERATËS ZVICERANE, PËRFAQËSUAR NGA SEKRETARIATI SHTETËROR ZVICERAN PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO), NË KUADËR TË FONDIT TË MIRËBESIMIT SECO, PËR FUQIZIMIN E KAPACITETEVE MBIKËQYRËSE TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF018931, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), në kuadër të fondit të mirëbesimit SECO, për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM
SHOQATA
NDËRKOMBËTARE E
ZHVILLIMIT

1818 H Street N.W.
Washington, D.C.
20433

U.S.A.

(202) 477-1234
Adresa kablllore:
INTBAFRAD

Adresa kablllore:
INDEVAS

[Datë]

SH e Tij, Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Re: Grant i SECO-s nr. TF018931
AMF në Shqipëri - Fondi i Mirëbesimit
SECO për Forcimin e Kapaciteteve
Mbikëqyrëse**

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për mbështetje financiare, të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Përfituesi), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), duke vepruar si administratore e fondeve të mbështetjes financiare, të dhëna nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) (Donatori), sipas Fondit të Mirëbesimit SECO për Forcimin e Kapaciteteve Mbikëqyrëse të AMF-së në Shqipëri (TF072353), propozon akordimin për Përfituesin të një mbështetjeje financiare në shumën që nuk tejkalon një milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e njëzet dollarë amerikanë e tetëdhjetë e një cent (1,583,720.81 US\$) (Granti), sipas termave dhe kushteve të përcaktuar apo të referuar në këtë Marrëveshje (Marrëveshja), e cila përfshin shtojcën e bashkëngjitur, për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në shtojcën (Projekti).

Ky Grant financohet nga fondi i mirëbesimit i sipërpërmendur, për të cilin Banka Botërore merr kontribute të herëpashershme nga donatorë. Në përputhje me pikën 3.02 të Kushteve Standarde (të përcaktuara në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës Botërore për pagesën në lidhje me këtë Marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve që i vihen asaj në dispozicion nga ana e donatorëve sipas fondit të posaçëm të sipërpërmendur, dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr shumat e Grantit varet nga disponueshmëria e këtyre fondeve.



Përfituesi, duke konfirmuar më poshtë pëlqimin e tij, deklaroi se është i autorizuar për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të zbatuar Projektin në përputhje me termit dhe kushtet e përcaktuar dhe të referuar në këtë Marrëveshje.

Ju lutemi, konfirmoni pëlqimin e Përfituesit lidhur me sa më lart, duke nënshkruar dhe duke vendosur datën në kopjen e Marrëveshjes së bashkëlidhur nga një funksionar i autorizuar nga Përfituesi, dhe dërgojeni në adresë të Bankës Botërore. Në momentin e marrjes së kësaj kopjeje të kundërnënshkruar, kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pas njoftimit nga ana e Përfituesit të përfundimit të procedurave të tij të brendshme; sidoqoftë, me kusht që oferta e kësaj Marrëveshjeje vlerësohet e anuluar në rast se Banka Botërore nuk ka marrë kopjen e sigluar të kësaj Marrëveshjeje dhe njoftimin përkatës brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Banka Botërore, me përjashtim të rastit kur Banka Botërore dhe Përfituesi kanë caktuar një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga _____

Ellen Goldstein
Drejtoreshë për vendin
Evropë dhe Azi Qendrore

PRANUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Datë: _____

Bashkëlidhur:

1. Kushtet Standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, datë 15 shkurt 2012;

2. Letër Disbursimi e datës së njëjtë me këtë Marrëveshje së bashku me udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet, datë 1 maj 2006;

3. “Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BNRZH-së dhe kreditë e IDA-së (Shoqata e Zhvillimit Ndërkombëtar) dhe Grantet”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011;

Faqe | 12716

4. “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas BNRZH-së dhe kredive IDA dhe Granteve nga Huamarrës të Bankës Botërore”, të janarit 2011, rishikuar në korrik 2014.

Grant i SECO-s, nr. TF018931

ANEKS

Neni I

Kushtet Standarde; përkufizime

1.01 Kushte Standarde. Kushtet standarde për Grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, datë 15 shkurt 2012 (Kushtet Standarde) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termit me germa kapitale të përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u jepen atyre në kushtet standarde ose në këtë Marrëveshje:

a) “Autoriteti Shqiptar i Mbikëqyrjes Financiare” ose “AMF” nënkupton Autoritetin Shqiptar të Mbikëqyrjes Financiare, një institucion publik i pavarur, i themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjin nr. 9572, të datës 3 korrik 2006, “Mbi Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” apo pasuesin e tij/të saj ligjor.

b) “Njësia Qendrore Financuese dhe Kontraktuese” ose “CFCU” nënkupton Njësinë Qendrore të Financimeve dhe Kontraktimeve të Ministrisë së Financës së Përfituesit ose pasardhësin e saj ligjor.

c) “Kostot operative” nënkupton kostot e arsyeshme, miratuar nga Banka Botërore, për shpenzimet përkatëse të hasura lidhur me zbatimin e Projektit, komunikimin dhe kosto të siguracioneve, taksat bankare, duplikimet/-printimet e dokumenteve, materialet e konsumit, kostot e udhëtimit dhe dietat për personelin e Projektit për udhëtimet që lidhen me zbatimin e Projektit.

d) “Trajnim” do të thotë kostot e arsyeshme, siç janë miratuar nga Banka Botërore, për trajnimin e zhvilluar sipas Projektit, duke përfshirë kostot e mësimdhënies, udhëtimit dhe transfertave për pjesëmarrësit në trajnime, kostot që lidhen me sigurimin e shërbimeve të trajnuesve dhe relatorëve në seminare, marrjen me qira të pajisjeve për trajnim, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zhvillimin e kurseve të trajnimit.



dhe zbatimin e tyre (por duke përjashtuar mallrat dhe shërbimet e konsulentëve).

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i Projektit. Objektivi i projektit është të mbështesë Autoritetin Shqiptar të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në forcimin e kapaciteteve të tij për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të fondeve të investimit dhe emetimit të obligacioneve korporative dhe të komunave. Projekti përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme:

a) Kryerja e një vlerësimi të përmbushjes së nevojave të mbikëqyrjes së AMF-së në lidhje me zhvillimin e shpejtë të sektorit të fondeve të investimit dhe përgatitjen e një manuali kohor të detajuar për zhvillimin e kapaciteteve përkatëse të AMF-së;

b) Zhvillimi i metodologjisë mbikëqyrëse për sektorin e fondeve të investimit, manualët dhe mjetet përkatëse;

c) Zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe profesionale të AMF-së, duke përfshirë në menaxhimin e Projektit dhe emetimin e obligacioneve korporative dhe atyre bashkiake;

d) Shqyrtimi i kornizës aktuale rregullatore dhe mbikëqyrëse të obligacioneve korporative dhe atyre bashkiake dhe sigurimi i rekomandimeve për përmirësimin e kornizës në fjalë.

2.02 Ekzekutimi i Projektit në përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, ai do të zbatojë Projektin nëpërmjet AMF-së, në përputhje me dispozitat e: a) nenit II të Kushteve Standarde; b) “Udhëzimet mbi parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga BNRZH-ja, Kreditë dhe Grantet IDA”, të datës 15 tetor, 2006 dhe rishikuar në janar 2011 (Udhëzimet antiko-rupsion); dhe c) këtij neni II.

2.03 Marrëveshje institucionale dhe të tjera: a) Përfituesi do të: i) ngarkojë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e Projektit në AMF; dhe ii) do të sigurojë që AMF-ja të realizojë projektin në përputhje me këtë Marrëveshje.

b) Për qëllime të zbatimit të Projektit, Përfituesi, nëpërmjet AMF-së do të mbajë në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit, një staf profesional në numrin e nevojshëm, me terma të referencës, kualifikime

dhe përvojë të pranueshme nga Banka Botërore.

c) Përfituesi do të sigurojë që gjatë gjithë zbatimit të projektit, CFCU-ja ofron për AMF-në mbështetje në prokurim, menaxhim financiar, si dhe në monitorim dhe në vlerësim.

2.04 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit. a) Përfituesi përmes CFCU-së monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe përgatit raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde dhe në bazë të treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo raport i Projektit do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dërgohet Bankës Botërore, jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Përfituesi, përmes Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, përgatit raportin përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde. Raporti Përfundimtar do t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Mbylljes.

2.05 Menaxhimi financiar: a) Përfituesi, përmes Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, do të sigurojë që sistemi i menaxhimit financiar të mbahet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të Kushteve Standarde.

b) Përfituesi, përmes Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, do të sigurojë përgatitjen e raporteve të përkohshme financiare të paaudituar për Projektin dhe dorëzimi e tyre për Bankën Botërore, jo më vonë se 45 (dyzet e pesë ditë) pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, duke mbuluar tremujorin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Përfituesi, përmes Njesisë Qendrore Financuese dhe Kontraktuese, do të auditojë pasqyrat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07/b të Kushteve Standarde. Çdo auditim i tillë i pasqyrave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Pasqyrat financiare të audituara për secilën periudhë do t'i dorëzohen Bankës Botërore jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.06 Prokurimi. Të gjitha shërbimet e konsulencës, të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen, tërësisht apo pjesërisht, nga të ardhurat e Grantit do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të BNRZH-së dhe IDA-



së, dhe granteve nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit janar 2011 dhe përditësuar në korrik 2014 (Udhëzimet e Konsulentit).

2.07 Çdo kontratë për shpenzimet e pranueshme, që do të financohen në mënyrë të plotë ose pjesërisht nga të ardhurat e Grantit do të përfshihet në planin e prokurimit të përgatitur nga Përfituesi, nëpërmjet CFCU-së, dhe të miratuar nga Banka në përputhje me Udhëzimet e Konsulentit, para fillimit të procesit të prokurimit për çdo kontratë të tillë.

Neni III

Tërheqja e të ardhurave të Grantit

3.01 Shpenzime të pranueshme. Përfituesi, nëpërmjet AMF-së mund të tërheqë shumën e Grantit, në përputhje me dispozitat e: a) nenit III të Kushteve Standarde; b) këtij seksioni; dhe c) udhëzimet shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë duke njoftuar Përfituesin (përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet”, të majit 2006, e rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe të zbatueshme për këtë Marrëveshje në zbatim të këtyre udhëzimeve), për financimin 100% të shpenzimeve të pranueshme, të cilat përbëhen nga trajnimi, kostot operative dhe shërbimet e konsulentëve, përfshirë taksat.

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të bëhen tërheqje:

a) për pagesat e bëra para datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Përfituesi;

b) deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

3.03 Periudha e tërheqjes, data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06/c të Kushteve Standarde, është data 30 qershor 2017.

Neni IV

Përfaqësuesi i Përfituesit; adresat

4.01 Përfaqësuesi i Përfituesit. Përfaqësuesi i Përfituesit, i përmendur në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde është Ministri i Financave.

4.02 Adresa e Përfituesit. Adresa e Përfituesit, e referuar në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde, është:

Ministri i Financave

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë

Faqe | 12718

Republika e Shqipërisë

Faks: +355 4 222 8405

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore, e përmendur në seksionin 7.01 të Kushteve Standarde, është:

International Bank for Reconstruction and Development

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Faks: 1-202-477-6391

VENDIM

Nr. 870, datë 30.10.2015

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF014999, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE TË GRANTIT, TË AKORDUAR NGA FONDI I MIRËBESIMIT ME SHUMË DONATORË, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË NISMËS PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË NXJERRËSE NË SHQIPËRI (EITI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF014999, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), me një shumë prej 300 000 (treqind mijë) USD sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**Banka Botërore**BANKA NDËRKOMBËTAR PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
U.S.A.(202) 477-1234
Adresë kabllore INTBAFRAD
Adresë kabllore: INDEVAS

30 tetor 2013

Shkëlqesisë së Tij
Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit
Nr. 4, Tiranë SHQIPËRIRef: **Shqipëria-Fondi i Besimit me Shumë-Donatorë për Iniciativën e
Transparencës së Industrisë Nxjerrëse
Granti i pas Përputhjes Grant Nr. TF014999**

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë ("Përfituesi"), kam kënaqësinë t'iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore"), duke vepruar si administratore e fondeve të Grantit të dhëna nga Australia, Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Bashkimi Evropian i përfaqësuar nga Komisioni Evropian, Finlanda, Franca, Gjermania, Japonia, Holanda, Norvegjia, Spanja, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara ("Donatorët"), sipas **Fontit të Besimit të Shumë Donatorëve për Iniciativën e Transparencës të Industrisë Nxjerrëse (EITI), Shërbimit të Mbështetjes së Implementimit**, propozon që t'i japë Përfituesit një grant në shumën që nuk kalon treqind mijë Dollarë të Shteteve të Bashkuara (US\$ 300,000) ("Granti") me termat dhe kushtet e parashikuara ose që përmenden në këtë Letër Marrëveshje ("Marrëveshja"), e cila përfshin Shtojcën e bashkëlidhur, për të asistuar me financimin e Projektit të përshkruar në Shtojcë ("Projekti").

Ky Grant financohet nga fondi i besimit i lartpërmendur për të cilin Banka Botërore merr kontributet periçdike nga donatorët. Në përputhje me Seksionin 3.02 të Kushteve Standarde (siç përcaktohet në Shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e pagesës së Bankës Botërore në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara me shumën e fondeve të vëna në dispozicion për të nga donatorët sipas fondit të besimit të lartpërmendur dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr shumat e Grantit i nënshtrohet disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Përfituesi përfaqëson, duke konfirmuar marrëveshjen e tij më poshtë, se ai është i autorizuar ta nënshkruajë këtë marrëveshje dhe të kryejë Projektin në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara ose të përmendura në këtë marrëveshje.



Ju lutemi konfirmoni pëlqimin e Përfituesit me sa më sipër duke garantuar që një zyrtar i autorizuar i Përfituesit të nënshkruajë dhe të vendosë datën në kopjen e bashkëlidhur të marrëveshjes dhe t'ia kthejë atë Bankës Botërore. Me marrjen e kësaj kopje të kundërfirmosur, kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e kundërfirmosjes; megjithatë me kushtin që oferta e kësaj marrëveshje do të konsiderohet e tërhequr nëse Banka Botërore nuk ka marrë kopjen e kundërfirmosur të marrëveshjes dhe njoftimin përkatës brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshje nga Banka Botërore, me përjashtim të rastit kur Banka Botërore dhe Përfituesit do të kenë caktuar një datë të mëvonshme për këtë qëllim.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ellen Goldstein

Nënshkrimi
Drejtores e Vendit për Ballkanin
Përfundimor për Evropën dhe
Rajonin e Azisë Qendrore

RËNË DAKORD:
SHQIPËRIA

NGA _____
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: _____
Titulli: _____
Data: _____

Bashkëlidhur:

- (1) Kushtet Standarde për Grantin e dhënë nga Banka Botërore nga disa Fonde të datës 15 shkurt 2012
- (2) Letra e Disbursimit e të njëjtës datë si kjo Marrëveshje bashkë me Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimin për Projektet e datës 1 maj 2006
- (3) Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftën Kundër Mashtrimit dhe Korrupsionin në Projektet e financuara nga huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në Janar 2011
- (4) Udhëzimet: Prokurimet e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve jo Konsulente sipas huave të IBRD-së dhe Kredive e Granteve të IDA-s, nga huamarrësit e Bankës Botërore, e muajit janar 2011
- (5) Udhëzimet: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive dhe Granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore, të muajit janar 2011.

TF014999
ANEKS

Neni I

Kushtet Standarde; Përkufizimet

1.01. **Kushtet Standarde.** Kushtet Standarde për Grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 15 shkurt 2012 ("Kushtet Standarde") përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshje.

1.02. **Përkufizimet.** Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që u jepet atyre në Kushtet Standarde ose në këtë Marrëveshje.

"EITI" do të thotë Iniciativa e Transparencës të Industrisë Nxjerrëse.

"MEI" do të thotë Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

"Grupi i Punës me Shumë Aktorë" ose "MSWG" do të thotë një grup që përbëhet nga përfaqësues nga Qeveria e Përfituesit, shoqëritë minerare dhe shoqëria civile dhe që është ngritur nga Përfituesi si një forum ku do të diskutohen dhe do të bihet dakord për vendimet në lidhje me procesin e EITI-t.

"Rajonet Prodhuese" janë rajonet ku nxirren mineralet ose nafta.

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01. **Objektivat dhe Përshkrimi i Projektit.** Objektivat e Projektit janë për të mbështetur qëllimet e përputhshmërisë pas-EITI të Shqipërisë për: (i) forcimin e rolit të EITI-t për prodhimin dhe publikimin e informacionit të rëndësishëm për qytetarët, veçanërisht për ata që jetojnë në rajonet prodhuese, duke përfshirë zgjerimin e gamës së procesit aktual EITI, duke rritur mbulimin e raporteve të EITI deri në nivele nën-kombëtare; dhe (ii) mbështetjen e qëllimeve të vendit për ta shtuar EITI-n për të përmirësuar menaxhimin dhe qeverisjen e përgjithshme në industrinë nxjerrëse. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa A. Komunikimi dhe Sensibilizimi, duke përfshirë iniciativën e Ushtrimit të Identifikimit të Zonave

Ofrimi i shërbimeve konsulente për zgjerimin e strategjisë së komunikimit me popullatën vendore dhe zhvillimin e ushtrimit të identifikimit të zonave, për të përfshirë mbledhjen e të dhënave në dy rajonet pilot.

Pjesa B. Trainimi Teknik dhe Përmirësimi i Kapacitetit dhe Njohurive të Sektorit



Ofrimi i shërbimeve të konsulentëve për të kryer trajnimin në rajonet e prodhuesit për aktorët vendorë, duke përfshirë mes të tjerash organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit e parlamentit, qeveritë vendore, gazetarët, aktivistët.

Pjesa C: Rritja e Gamës së Raportimit të EITI-t

Ofrimi i shërbimeve të konsulentëve dhe takimeve të punës për të përmirësuar raportimin e EITI-t.

Pjesa D: Rritja e rëndësisë strategjike të EITI-t duke përcaktuar etapat e shifrave të Raportit të EITI-t me potencialin e mundshëm të sektorit

Ofrimi i shërbimeve të konsulentëve që do t'i japin MSWG-së të dhëna dhe modele për performancën e sektorit.

Pjesa E: Mbështetja Operacionale

Ofrimi i trajnimit të personelit kyç të sekretariatit të EITI-t.

2.02. Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi do të kryejë Projektin nëpërmjet MEI-t, në përputhje me dispozitat e: (a) Nenit II të Kushteve Standarde; (b) "Udhëzimeve për Parandalimin dhe Luftën Kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit dhe Projektet e Financuara nga Huatë e IBRD-së dhe Kreditë dhe Grantet e IDA-s", të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 ("Udhëzimet Kundër Korrupsionit"); dhe (c) këtij Neni II.

2.03. Marrëveshjet Institucionale dhe Marrëveshjet e Tjera

(a) MEI do të mbajë gjatë gjithë kohës gjatë zbatimit të Projektit Sekretariatit e EITI brenda MEI-t që do të përgjigjet për koordinimin e aktiviteteve të Projektit dhe operacionet e përditshme të tij. Gjatë gjithë kohës nëpërmjet zbatimit të Projektit, Përfituesi do t'i ofrojë sekretariatit të EITI-t hapësirë zyrash, pajisjet e nevojshme të zyrës dhe furnizimet dhe do të mbulojë të gjitha shërbimet komunale publike.

(b) Përfituesi nuk do të përdorë shumat financiare të Grantit për qëllimin e ndonjë pagese për personat apo subjektet ose për importin e mallrave nëse kjo pagesë ose ky import, sipas njohurive ose besimit të Përfituesit, ndalohet nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë edhe sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1373 dhe rezolutat që lidhen me të.



2.04 Vizibiliteti dhe Vizitat e Donatorit

(a) Përfituesi do të marrë ose do të bëjë që të merren të gjitha masat që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e donatorit për projektin.

(b) Për qëllimet e Seksionit 2.09 të Kushteve Standarde, Përfituesi, me kërkesën e Bankës Botërore, do të marrë të gjitha masat që kërkohen nga ana e tij për tu mundësuar përfaqësuesve të Donatorit (Donatorëve) që të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të Përfituesit për qëllimet e lidhura me Projektin.

2.05. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

(a) Përfituesi do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e Projektit dhe do të përgatitë raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.06 të Kushteve Standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm nga Banka Botërore, shihni Aneksin I. Secili Raport Projekti do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas fundit të periudhës të mbuluar nga ky raport.

(b) Përfituesi do të përgatisë raportin e përfundimit në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.06 të Kushteve Standarde. Raporti përfundimit do t'i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.06. Menaxhimi Financiar

(a) Përfituesi do të sigurojë që të ketë një sistem të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.07 të Kushteve Standarde.

(b) Përfituesi do të sigurojë që raportet financiare të ndërmjetme tre mujore të pa-audituar për Projektin të përgatiten dhe t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas fundit të çdo tre mujori kalendarik, duke e mbuluar atë tre mujor në formë dhe përmbajtje sipas kërkesave të Bankës Botërore.

(c) Përfituesi, me kërkesën e Bankës Botërore, do të kryejë auditimin e Pasqyrave Financiare në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.07 (b) të Kushteve Standarde. Çdo audit i tillë i Pasqyrave Financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Deklaratat financiare të audituara për çdo periudhë të tillë do t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas fundit të kësaj periudhe.

2.07. Prokurimi.

(a) **Të përgjithshme.** Të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet konsulente që kërkohen për Projektin dhe që do të financohen, tërësisht ose pjesërisht nga shumat e Grantit, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose që përmenden në:



(i) Seksionin I të "Udhëzimeve: Prokurimi i Mallrave dhe Shërbimeve jo Konsulente në kuadrin e Huave të IBRD-së dhe Kredive dhe Granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 ("Udhëzimet e Prokurimit"), në rastin e mallrave; dhe

(ii) Seksioni I dhe IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve në kuadrin e Huave të IBRD-së dhe të Kredive dhe Granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 ("Udhëzimet e Konsulentit") në rastin e shërbimeve të konsulentëve.

(b) **Përkufizimet.** Termat me germa kapitale të përdorura në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metodat e veçanta të konkurrimit ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të veçanta, u referohen vetëm metodave përkatëse të shkruara në Udhëzimet e Prokurimit ose Udhëzimet e Konsulentit, sipas rastit.

(c) **Metodat e Veçanta të Prokurimit të Mallrave.** Mallrat dhe shërbimet, të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve, do të prokurohen sipas kontratës së dhënë mbi bazën e blerjes dhe Kontraktimit të Drejtpërdrejtë (DC). DC mund të përdoret duke iu nënshtruar miratimit paraprak të Bankës, për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve që plotësojnë kërkesat për DC-në që përmenden në paragrafin 3.6 të Udhëzimeve dhe Prokurimit.

(d) **Metodat e Veçanta të Prokurimit të Shërbimeve të Konsulentëve.** Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato transferime detyrash me të cilat Banka Botërore bie dakord se përmbushin kriteret e parashikuara në Udhëzimet e Konsulentit për përdorimin e tyre: (A) Përzgjedhja e Bazuar tek Cilësia dhe Kostoja; (B) Përzgjedhja me Buxhet Fiks; (C) Përzgjedhja me Koston më të Ulët; (D) Përzgjedhja e Bazuar në Kualifikimet e Konsulentëve; (E) Përzgjedhja me një Burim të Vetëm; dhe (F) Përzgjedhja e Konsulentëve Individualë.

(e) **Rishikimi nga Banka Botërore i Vendimeve të Prokurimit.** Përveç rastit kur Banka Botërore do të përcaktojë ndryshe me njoftim për Përfituesin, kontratat e mëposhtme do t'i nënshtrohen shqyrtimit paraprak nga Banka Botërore: (a) dy kontratat e para që do të jepen në përputhje me metodën e blerjes; (b) termat e referencës për çdo kontratë për shërbimet e konsulentëve; (c) çdo kontratë për shërbimet e konsulentëve me një firmë të vlerësuar se kushton sa ekuivalenti i \$100,000 ose më shumë; (d) çdo kontratë për shërbimet e konsulentëve me një konsulent të veçantë që vlerësohet se kushton sa ekuivalenti i \$50,000 ose më shumë; dhe (e) të gjitha kontratat me metodat e përzgjedhjes me kontraktim të drejtpërdrejtë ose me burim të vetëm. Të gjitha kontratat do t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëpasshëm nga Banka Botërore

Neni III Tërheqja e Shumave të Grantit

3.01. **Shpenzimet e Pranueshme.** Përfituesi mund të tërheqë shumat e Grantit në përputhje me dispozitat e: (a) Nenit III të Kushteve Standarde; (b) të këtij Seksioni; dhe (c) sipas udhëzimeve të tilla shtesë që Banka Botërore mund të specifikojë me njoftim për Përfituesin (duke përfshirë "Udhëzimet e Disbursimit të Bankës Botërore për Projektet" të muajit maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka Botërore dhe siç bëhen të zbatueshme për këtë marrëveshje sipas këtyre



udhëzimeve), për të financuar Shpenzimet e Pranueshme që parashikohen në tabelën e mëposhtme. Tabela specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranuar që mund të financohen nga shumat e Grantit ("Kategoria"), alokimet e shumave të Grantit për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen për Shpenzimet e Pranuar në çdo Kategori.

Kategoria	Shuma e Grantit të Alokuar (e shprehur me USD)	Përqindja e Shpenzimeve që do financohen (duke përfshirë Taksat)
Mallrat, shërbimet e konsulentëve, kostot e trajnimit dhe operimit	300,000	100%
SHUMA TOTALE	300,000	

Për qëllimet e këtij Seksioni:

(a) Termi "Trajnim" do të thotë kurset e trajnimit, takimet e punës dhe udhëtimet studimore të kryera në kuadrin e Projektit, duke përfshirë blerjen dhe publikimin e materialeve, marrjen me qira të ambienteve dhe pajisjeve, shpenzimet e udhëtimit dhe mjetet e jetesës ose dietat për kursantët.

(b) Termi "Kostot Operative" do të thotë kostot operative në rritje të kryera nga Përfituesi për shkak të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit të Projektit, duke përfshirë pagesat bankare, pagat e personelit të Sekretariatit EITI dhe kosto të tjera të ndryshme që shoqërohen drejtpërdrejt me Projektin dhe të pranueshme për Bankën Botërore.

3.02. **Kushtet e Tërheqjes.** Pavarësisht dispozitave të Seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e kryera përpara datës së kundërfirmosjes së kësaj Marrëveshjeje nga Përfituesi.

3.03. **Periudha e Tërheqjes.** Data e mbylljes që përmendet në Seksionin 3.06 (c) të Kushteve Standarde është 30 qershor 2015.

Neni IV

Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat

4.01. **Përfaqësuesi i Përfituesit.** Përfaqësuesi i Përfituesit që përmendet në Seksionin 7.02 të Kushteve Standarde është Ministri i Financave.

4.02. **Adresa e Përfituesit.** Adresa e Përfituesit që përmendet në Seksionin 7.01 të Kushteve Standarde është:

Shkëlqesia e Tij, Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Dëshmorët e Kombit Nr.4

Tiranë, Shqipëri

4.03. **Adresa e Bankës Botërore.** Adresa e Bankës Botërore që përmendet në Seksionin 7.01 të Kushteve Standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Shoqata e Zhvillimit Ndërkombëtar
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Faks: 1-202-477-6391



Aneksi I

Treguesit e Rezultateve dhe Monitorimi e Vlerësimi

Treguesit Kyç të Performancës	Data Treguese e Dërgimit
Raporti i 3-të i EITI-t me të dhëna të zbërthyera	
Prodhimi dhe shpërndarja e raportit të tretë EITI	Raporti i tretë EITI do të mbulojë të dhënat nga 2011 të paraqitura të zbërthyera. Në varësi të rezultateve të takimit të punës sipas objektit, ai mund të përfshijë edhe shpërndarjen nën-kombëtare të të ardhurave. Raporti do të jetë i disponueshëm në tremujorin e katërt të vitit 2013.
Studim i mundshëm për livrimin e të ardhurave	
Studimi që shqyrton potencialin e të ardhurave të industrive nxjerrëse të Shqipërisë në lidhje me studimet e çështjeve të vështirësive dhe praktikës së mirë do të hartohet, diskutohet publikisht dhe shpërndahet	Hartimi i studimit- tremujori i dytë i vitit 2014. Takimet publike- tremujori i katërt i vitit 2014.
Kryerja e Trajnimit Teknik	
Trajnimi specifik i sektorit EITI do të kryhet nëpërmjet takimeve të punës për aktorë të ndryshëm	Çështje teknike të EI që janë me interes rajonal/vendor do të kryhen për aktorë të ndryshëm, duke përfshirë CSO dhe parlamentarët, që do të kryhen në rajone të ndryshme të prodhuesit. Gjithsej katër takime pune do të kryhen në tremujorin e parë -2014, tremujorin e tretë-2014, tremujorin e katërt-2014 dhe tremujorin e parë-2015.
Komunikimi dhe Sensibilizimi	
Takimet rajonale të punës të kryera për aktorët për të vlerësuar nevojat e trajnimit	Tre takime pune specifike sektoriale do të zhvillohen në dy rajone minerare (Tremujori i parë i vitit 2014 dhe tremujori i dytë i vitit 2014) dhe rajoni kryesor i prodhimit të naftës (tremujori i tretë i vitit 2014) Shpërndarja e informacionit përkatës të EI me një kontekst specifik rajonal dhe i mbështetur nëpërmjet gazetarëve të trajnuar. Strategjia e Komunikimit specifik rajonal, gati në tremujorin e parë të vitit 2014 dhe e zbatuar gjatë të gjithë periudhës së Grantit Kërkesa për të dhëna do të vlerësohet në dy
	takime pune rajonale të cilat do të zhvillohen në tremujorin e parë dhe tremujorin e dytë të vitit 2014. Termat e Referencës do të plotësohen tremujorin e dytë të vitit 2014.



**KUSHTET STANDARDE PËR GRANTET E DHËNA NGA BANKA BOTËRORE
NGA FONDE TË NDRYSHME
(datë 15 shkurt 2012)**

**NENI I
Dispozitat Hyrëse**

Seksioni 1.01. *Zbatimi i Kushteve Standarde.* Këto Kushte standarde parashikojnë terma dhe kushte të caktuara të zbatueshme në përgjithësi për grantet e dhëna nga IBRD ose IDA nga fonde të ndryshme (të ndryshme nga burimet IDA). Ato zbatohen deri në masën që specifikohet në Marrëveshjen e Grantit.

Seksioni 1.02. *Mospërputhshmëria me Marrëveshjen e Grantit.* Nëse ndonjë dispozitë e Marrëveshjes së Grantit nuk përputhet me një dispozitë të këtyre Kushteve Standarde, dispozita e Marrëveshjes së Grantit do të ketë përparësi.

Seksioni 1.03. *Përkufizimet.* Përveç kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Grantit, kurdoherë që termat me germa kapitale përdoren në këto Kushte Standarde ose në Marrëveshjen e Grantit, ato kanë kuptimet që u jepen atyre me këto Kushte Standarde.

Seksioni 1.04. *Referencat; Titujt.* Referencat në këto Kushte Standarde për Nenet dhe Seksionet janë për Nenet dhe Seksionet e këtyre Kushteve Standarde. Titujt e tyre përfshihen në këto Kushte Standarde vetëm për Referencë dhe nuk do të merren në konsideratë në interpretimin e këtyre Kushteve Standarde.

**NENI II
Ekzekutimi i Projektit**

Seksioni 2.01. *Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi.* Përfituesi do të sigurojë që:

(a) Projekti kryhet: (i) me kujdesin dhe efikasitetin e duhur; (ii) në përputhje me standardet dhe praktikën e duhura administrative, teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe shoqërore; dhe (iii) në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit, duke përfshirë këto Kushte Standarde; dhe

(b) Fondet, huatë, shërbimet dhe burimet e tjera që kërkon Projekti, jepen menjëherë siç nevojiten.

Seksioni 2.02. *Siguracioni.* Përfituesi do të garantojë masa të mjaftueshme për siguracionin e çdo malli që kërkohet për projektin dhe do të financohet nga shumat e Grantit, kundrejt rreziqeve të lidhura me blerjen, transportimin dhe livrimin e mallrave deri në vendin e përdorimit ose instalimit të tyre. Çdo zhdëmtim për këtë siguracion do të jetë i pagueshëm në një monedhë lirisht të përdorshme për të zëvendësuar ose riparuar këto mallra.

Seksioni 2.03. *Blerja e Tokës.* Përfituesi do të sigurojë që të ndërmerren të gjitha masat për të blerë siç duhet dhe kur duhet të gjithë tokën dhe të drejtat mbi tokën që kërkohen për të kryer



projektin dhe do t'i japë menjëherë Bankës Botërore, me kërkesën e saj, të dhëna që kërkon Banka Botërore se kjo tokë dhe këto të drejta janë të disponueshme për projektin.

Seksioni 2.04. *Përdorimi i Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve; Mirëmbajtja e Ambienteve.* Përfituesi do të sigurojë që:

(a) përveç rastit kur Banka Botërore bie dakord ndryshe, të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga shumat e Grantit të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e projektit; dhe

(b) të gjitha shërbimet që lidhen me projektin të vihen në përdorim dhe të mirëmbahen gjatë gjithë kohës siç duhet dhe të kryhen menjëherë të gjitha riparimet dhe rinovimet që nevojiten për këto shërbime.

Seksioni 2.05. *Dokumentet; Të dhënat.* Përfituesi do të sigurojë që:

(a) të gjitha dokumentet që lidhen me projektin t'i jepen Bankës Botërore me kërkesën e saj, me ato detaje që Banka Botërore do t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme;

(b) të dhënat mbahen të sakta për të regjistruar progresin e projektit (duke përfshirë koston e tij dhe fitimet që rrjedhin prej tij), për të identifikuar mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga shumat e Grantit dhe për të publikuar përdorimin e tyre në projekt, dhe këto të dhëna i jepen Bankës Botërore menjëherë me kërkesën e saj;

(c) të gjitha të dhënat që provojnë shpenzimet sipas projektit mbahen deri të paktën (i) dy vjet pas Datës së Mbylljes; ose (ii) nëse Banka Botërore kërkon audite për Pasqyrat Financiare të Përfituesi sipas Seksionit 2.07 (b) më poshtë, më vonë se: (A) një vit pasi Banka Botërore të ketë marrë pasqyrat financiare të audituara që mbulojnë periudhën gjatë së cilës është bërë tërheqja e fundit nga llogaria e Grantit; dhe (B) dy vjet pas datës së mbylljes; dhe

(d) përfaqësuesit e Bankës Botërore të jenë në gjendje të shqyrtojnë të gjitha të dhënat që përmenden më sipër në paragrafët (b) dhe (c) dhe që të jepet i gjithë ai informacion në lidhje me këto të dhëna që do ta kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 2.06. *Monitorimi i Projektit, Raportimi dhe Vlerësimi.* Përfituesi:

(a) do të sigurojë zbatimin e politikave dhe procedurave të sakta që t'i mundësojë atij monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me treguesit e pranueshëm për Bankën Botërore, progresin e projektit dhe arritjen e objektivave të tij; dhe

(b) nëse kjo kërkohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit:



(i) (A) Të sigurojë përgatitjen dhe dërgimin tek Banka Botërore të një ose më shumë raporteve të projektit ("Raportet e Projektit") në formën dhe përmbajtjen që plotëson kërkesat e Bankës Botërore, duke integruar rezultatet e këtyre aktiviteteve monitoruese dhe vlerësuese dhe duke përcaktuar masa të rekomanduara nga Përfituesi për të siguruar ekzekutimin eficient dhe efektiv të projektit dhe për të arritur objektivat e projektit; çdo raport projekti të mbulojë periudhën e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit dhe t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se data e specifikuar për atë qëllim në Marrëveshjen e Grantit; dhe (B) t'i japë Bankës Botërore një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer pikëpamjet me Përfituesin për këtë raport, dhe pas kësaj të zbatojë këto masa të rekomanduara, duke marrë parasysh pikëpamjet e Bankës Botërore për këtë çështje; dhe

(ii) të sigurojë përgatitjen dhe dërgimin tek Banka Botërore, jo më vonë se data e specifikuar për atë qëllim në Marrëveshjen e Grantit të një ose më shumë raporteve të përfundimit ("Raportet e Përfundimit"); (A) të këtij objekti dhe me ato detaje që Banka Botërore do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për ekzekutimin e Projektit, performancën e Përfituesi dhe Banka Botërore për detyrimet e saj përkatëse sipas Marrëveshjes së Grantit dhe përmbushjen e qëllimeve të Grantit dhe (B) një plan të hartuar për të siguruar qëndrueshmërinë e arritjeve të projektit.

Seksioni 2.0.7. *Menaxhimi Financiar; Pasqyrat Financiare; Auditet.* Përfituesi do të sigurojë që:

(a) të ketë një sistem menaxhimi financiar dhe të përgatiten pasqyrat financiare ("Pasqyrat Financiare") në përputhje me standardet e kontabilitetit të aplikuara në mënyrë të vazhdueshme për Bankën Botërore, të dyja në mënyrën e duhur për të pasqyruar operacionet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me Projektin;

(b) nëse kërkohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit: (i) Pasqyrat Financiare të auditohen në mënyrë periodike nga auditues të pavarur të pranueshëm për Bankën Botërore, në përputhje me standardet audituese të zbatuara në mënyrë të qëndrueshme të pranueshme për Bankën Botërore; dhe (ii) Pasqyrat Financiare, të audituara në këtë mënyrë, t'i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se data e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit për atë qëllim, së bashku me informacione të tjera në lidhje me Pasqyrat Financiare të audituara dhe audituesit e tyre, siç mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka Botërore; dhe

(c) pasqyrat Financiare të audituara sipas paragrafit (b) të këtij Seksioni të vihen në dispozicion publikisht në kohën e duhur dhe në një mënyrë të pranueshme për Bankën Botërore.

Seksioni 2.0.8. *Bashkëpunimi dhe Konsulenca.* Përfituesi dhe Banka Botërore do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimet e Grantit dhe objektivat e Projektit të



përmbushen, dhe për këtë qëllim, gjatë të gjithë zbatimit të Projektit dhe për një periudhë prej dhjetë vitesh më pas:

(a) herë pas here me kërkesën e secilit prej tyre, të shkëmbejnë pikëpamje për Projektin, Grantin dhe kryerjen e detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjes së Grantit dhe t'i japin palës tjetër të gjithë informacionin që lidhet me këto çështje, siç do të kërkohej prej saj në mënyrë të arsyeshme; dhe

(b) të informojë menjëherë palën tjetër për ndonjë kusht që ndërhyt ose rrezikon të ndërhyt në këto çështje;

Seksioni 2.0.9. *Vizitat*. Përfituesi, gjatë të gjithë zbatimit të Projektit dhe për një periudhë prej dhjetë vitesh më pas:

(a) nëse është Vend Anëtar, do të mundësojë përfaqësuesve të Bankës Botërore që të vizitojnë një pjesë të territorit të tij për qëllimet që lidhen me Grantin;

(b) nëse nuk është Vend Anëtar, do të marrë të gjitha masat që kërkohej nga ana e tij që t'i mundësojë Bankës Botërore të vizitojë një pjesë të territorit të Vendi Anëtar për qëllimet që lidhen me Grantin; dhe

(c) do t'i mundësojë përfaqësuesve të Bankës Botërore: (i) që të vizitojnë ndonjë ambient dhe kantier që përfshihen në Projekt; dhe (ii) të kontrollojë mallrat e financuara nga shumat e Grantit dhe çdo dokument që lidhet me përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes së Grantit.

Seksioni 2.10. *Zonë Mosmarrëveshjeje*

Në rast se Projekti është një zonë e cila është ose bëhet e diskutueshme, as financimi i Bankës Botërore për Projektin, as ndonjë përcaktim apo referencë për këtë zonë në Marrëveshjen e Grantit nuk synohet që të përbëjë ndonjë gjykim nga ana e Bankës Botërore në lidhje me statusin ligjor apo ndonjë status tjetër të kësaj zone ose nuk cenon përcaktimin e ndonjë pretendimi në lidhje me këtë zonë.

NENI III

Tërheqja e Shumave të Grantit

Seksioni 3.01. *Llogaria e Grantit; Tërheqjet në Përgjithësi; Monedha e Tërheqjeve*

(a) Banka Botërore do të kreditojë shumën e Grantit në monedhën e përcaktuar të Grantit për llogarinë e Grantit. Përfituesi herë pas here kërkon tërheqje të shumave të Grantit nga llogaria e Grantit në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit dhe këto Kushte Standarde.



(b) Tërheqjet e shumave të Grantit nga llogaria e Grantit do të kryhen në monedhën e përcaktuar të Grantit. Banka Botërore, me kërkesë dhe duke vepruar si agjent i Përfituesit, me ato terma dhe kushte që Banka Botërore do të përcaktojë, mund të blejë me këtë monedhë të tërhequr nga llogaria e Grantit monedha të tjera të tilla që Përfituesi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer pagesat për Shpenzimet e Pranueshme. Kurdoherë që do të jetë e nevojshme për qëllimin e Marrëveshjes së Grantit apo të këtyre Kushteve Standarde për të përcaktuar vlerën e një monedhe me termat e një monedhe tjetër, kjo vlerë do të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga Banka Botërore.

Seksioni 3.02. *Mungesa e Financimit*. Pavarësisht dispozitave të Seksionit 3.01, asnjë tërheqje nuk do të bëhet nëse, si rezultat i kësaj tërheqjeje, shuma totale e Grantit të tërhequr nga llogaria e Grantit do të tejkalojë shumën në dispozicion për Bankën Botërore nga burimet e fondit të besimit që i jepen asaj nga financues të tjerë për qëllimet e Grantit. Përfituesi do të përballojë riskun e ndonjë mungese të tillë financimi dhe Banka Botërore nuk do të ketë asnjë lloj detyrimi ndaj Përfituesi apo ndonjë pale të tretë në lidhje me ndonjë shpenzim apo detyrim të kryer në lidhje me Marrëveshjen e Grantit, i cili tejkalon shumën e vënë në dispozicion për Bankën Botërore për qëllimet e Grantit.

Seksioni 3.03. *Angazhimi i Veçantë nga Banka Botërore*. Me kërkesën e Përfituesi dhe me ato terma dhe kushte që Përfituesi dhe Banka Botërore do të bien dakord, Banka Botërore mund të ndërmarrë angazhime të veçanta me shkrim për të paguar shuma për Shpenzimet e Pranueshme, pavarësisht ndonjë pezullimi apo anulimi të mëvonshëm të një shume të Grantit ("Angazhimi i Veçantë").

Seksioni 3.04. *Aplikimet; Provat Mbështetëse*

(a) Kur Përfituesi dëshiron të tërheqë një shumë nga llogaria e Grantit apo t'i kërkojë Bankës Botërore që të ndërmarrë një angazhim të veçantë, Përfituesi do t'i dërgojë Bankës Botërore një aplikim me shkrim për qëllimin në formë dhe përmbajtje të tillë që do ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka Botërore ("Aplikimi")

(b) Përfituesi do t'i japë Bankës Botërore: (i) prova sipas kërkesave të Bankës Botërore për autoritetin e personit apo personave që autorizohen të nënshkruajnë çdo aplikim dhe modelin e vërtetuar të nënshkrimit të çdo personi të tillë; dhe (ii) këto dokumente dhe prova të tjera në mbështetje të çdo aplikimi që do ta specifikojë Banka Botërore, qoftë para apo pas lejimit nga Banka Botërore të ndonjë tërheqje të tillë të kërkuar në Aplikim ("Provat Mbështetëse").

(c) Çdo aplikim për një shumë të Grantit, dhe Provat Mbështetëse, duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të plotësuar kërkesat e Bankës Botërore që Përfituesi të ketë të drejtën të tërheqë këtë shumë nga llogaria e Grantit dhe që kjo shumë do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit. Aplikimet do të bëhen menjëherë në lidhje me Shpenzimet e Pranueshme.



(d) Banka Botërore do të paguajë shumat e tërhequra nga Përfituesi nga llogaria e Grantit vetëm me porosi të Përfituesit.

Seksioni 3.05. *Llogaritë e Përcaktuara*

(a) Përfituesi mund të hapë dhe të mbajë një ose disa llogari të përcaktuara me të cilat Banka Botërore me kërkesën e Përfituesi mund të depozitojë shuma të tërhequra nga llogaria e Grantit si parapagime për qëllimet e Projektit ("Llogaritë e Përcaktuara"). Të gjitha Llogaritë e Përcaktuara do të hapen në një institucion financiar të pranueshëm për Bankën Botërore dhe me termat dhe kushtet e pranueshme për Bankën Botërore.

(b) Depozitat në llogarinë e përcaktuar dhe pagesat prej saj do të bëhen në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe këto Kushte Standarde dhe udhëzime shtesë siç mund ta specifikojë Banka Botërore herë pas here duke njoftuar Përfituesin. Banka Botërore, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe këto udhëzime, mund të ndërpresë bërjen e depozitave në ndonjë prej këtyre llogarive duke e njoftuar Përfituesin. Në këtë rast, Banka Botërore do ta njoftojë Përfituesin për procedurat që do të përdoren për tërheqjet e mëvonshme nga llogaria e Grantit.

Seksioni 3.06. *Shpenzimet e Pranueshme*. Përfituesi do të sigurojë që shumat e Grantit të përdoren ekskluzivisht për të financuar shpenzimet të cilat, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Grantit, do të plotësojë kërkesat e mëposhtme ('Shpenzimet e Pranueshme'):

(a) pagesa është për koston e arsyeshme të mallrave, punimeve ose shërbimeve që kërkon Projekti, për tu financuar nga shumat e Grantit dhe për tu prokuruar, të gjitha në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit;

(b) pagesa nuk ndalohej nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas Kapitullit VII të Kartës të Kombeve të Bashkuara; dhe

(c) pagesa (i) bëhet në datën e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit për atë qëllim ose pas saj; dhe (ii) përveç rastit kur Banka Botërore bie dakord ndryshe, është për shpenzimet e kryera përpara Datës së Mbylljes.

Seksioni 3.07. *Taksat e Financimit*

(a) Marrëveshja e Grantit mund të specifikojë që shumat e Grantit nuk mund të tërhiqen për të paguar taksat e vendosura nga një Vend Anëtar apo në territorin e tij për apo në lidhje me Shpenzimet e Pranueshme, ose importimin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre. Në këtë rast, nëse shuma e ndonjë Takse të tillë rritet apo ulet, Banka Botërore duke njoftuar Përfituesin, mund ta rregullojë përqindjen e këtyre Shpenzimeve të Pranueshme që të financohen nga shumat e Grantit të specifikuara në Marrëveshjen e Grantit, siç kërkohet për të siguruar vazhdimësinë e këtij kufizimi mbi tërheqjet.



(b) Megjithatë, në mungesë të një specifikimi të tillë, përdorimi i çdo shume të Grantit për të paguar për këto Taksa, i nënshtrohet politikës së Bankës Botërore që kërkon ekonomi dhe efikasitet në përdorimin e shumave të kredive dhe granteve të saj. Për këtë qëllim, nëse Banka Botërore në çfarëdo kohe vendos se shuma e çdo takse të tillë është e tepërt ose se Taksa është diskriminuese ose ndryshe e paarsyeshme, Banka Botërore, duke njoftuar Përfituesin, mund të rregullojë përqindjen e këtyre Shpenzimeve të Pranueshme që do të financohen nga shumat e Grantit të specifikuara në Marrëveshjen e Grantit, siç kërkohet për të siguruar vazhdimësinë e kësaj politike të Bankës Botërore.

Seksioni 3.08. *Rialokimi*. Nëse sipas opinionit të Bankës Botërore, një shumë e Grantit që i alokohet një kategorie të Shpenzimeve të Pranueshme sipas Marrëveshjes së Grantit do të jetë e pamjaftueshme për të financuar shpenzimet në këtë kategori, Banka Botërore, duke njoftuar Përfituesin mund:

(a) T'i riallokojë kësaj kategorie ndonjë shumë tjetër të Grantit e cila sipas mendimit të Bankës Botërore nuk nevojitet për Shpenzime të tjera të Pranueshme, deri në masën që kërkohet për të plotësuar mungesën e vlerësuar; dhe

(b) Nëse ky riallokim nuk do të plotësojë tërësisht mungesën e vlerësuar, mund të ulë përqindjen e Shpenzimeve të Pranueshme që do të financohen në këtë kategori në mënyrë që tërheqet e mëtejshme për këto shpenzime të mund të vazhdojnë derisa të gjitha shpenzimet të jenë kryer.

NENI IV

Anulimi; Pezullimi; Rifinancimi i Grantit

Seksioni 4.01. *Anulimi i Përfituesit*. Përfituesi, me njoftim nga Banka Botërore, mund të anulojë ndonjë shumë të patërhequr të Grantit, përveç se Përfituesi nuk mund të anulojë ndonjë shumë të tillë që i nënshtrohet një angazhimi të veçantë.

Seksioni 4.02. *Pezullimi nga Banka Botërore*. Banka Botërore me një njoftim për Përfituesin, mund të pezullojë të drejtën e Përfituesit që të bëjë tërheqjen nga Llogaria e Grantit nëse ndodh dhe vazhdon ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme. Ky pezullim do të vazhdojë derisa Banka Botërore të ketë njoftuar Përfituesin se kjo e drejtë për të bërë tërheqje është rivendosur.

(a) *Ndërhyrja*. Nëse Granti i është bërë një Përfituesi i cili nuk është Vend Anëtar, Vendi Anëtar: (i) ka marrë ose ka lejuar që të ndërmerret një veprim i cili do të parandalonte ose të ndërhynte në ekzekutimin e Projektit ose për përmbushjen nga Përfituesi të detyrimeve sipas Marrëveshjes së Grantit; ose (ii) nuk ka arritur të ofrojë një mundësi të arsyeshme për përfaqësuesit e Bankës Botërore që të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të tij për qëllimet që lidhen me Grantin ose Projektin.

(b) *Mospërmbushja*. Përfituesi nuk ka arritur të përmbushë ndonjë detyrim sipas Marrëveshjes së Grantit.



(c) *Mashtrimi dhe Korrupsioni.* Në çdo kohë, Banka Botërore vendos se ndonjë përfaqësues i Përfituesit (ose Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vend Anëtar, ose ndonjë Përfituesi tjetër i ndonjë shume të Grantit) është përfshirë në praktika korruptuese, mashtruese, shtrënguese ose komplotuese në lidhje me përdorimin e shumave të Grantit, dhe Përfituesi (ose Vendi Anëtar i ndonjë Përfituesi tjetër të tillë) nuk kanë ndërmarrë veprimet e duhura dhe në kohë që të plotësojnë kërkesat e Bankës Botërore për të trajtuar këto praktika kur ato ndodhin.

(d) *Pezullimi i Kryqëzuar.* IBRD ose IDA ka pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Përfituesit (ose të Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vend Anëtar) që të bëjë tërheqje sipas ndonjë marrëveshje me IBRD-në ose IDA-n për shkak të mospërbushjes nga ana e Përfituesit (ose ndonjë Vend Anëtar) të detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër me IBRD ose IDA.

(e) *Situata e Jashtëzakonshme.* Si rezultat i ngjarjeve të cilat kanë ndodhur pas datës së Marrëveshjes së Grantit, ka lindur një situatë e jashtëzakonshme e cila e bën të pamundur që të kryhet Projekti ose që Përfituesi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet sipas Marrëveshjes së Grantit.

(f) *Keqpërfaqësimi.* Një përfaqësim i bërë nga Përfituesi në Marrëveshjen e Grantit ose sipas saj, ose ndonjë përfaqësim apo deklaram i dhënë nga Përfituesi dhe i synuar që Banka Botërore të mbështetet në të për dhënien e Grantit, ishte i pasaktë në çdo drejtim material.

(g) *Kalimi i Detyrimeve; Disponimi i Aseteve.* Përfituesi (ose ndonjë subjekt tjetër që përgjigjet për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) pa pëlqimin e Bankës Botërore: (i) ka kaluar ose transferuar tërësisht ose pjesërisht ndonjë nga detyrimet e tij që lindin sipas ose për të cilat do të bihet dakord sipas kësaj Marrëveshjeje Granti; ose (ii) është shitur, dhënë me qera, transferuar, kaluar ose disponuar në një mënyrë tjetër për ndonjë pronë ose aset të financuar tërësisht ose pjesërisht nga shumat e Grantit; me kushtin që sidoqoftë, dispozitat e këtij paragrafi të mos zbatohen në lidhje me transaksionet në rrjedhën e zakonshme të biznesit e cila, sipas mendimit të Bankës Botërore: (A) nuk e prek materialisht ose nuk bie ndesh me aftësinë e Përfituesit (ose ndonjë subjekti tjetër të tillë) për të përmbushur detyrimet që lindin sipas Marrëveshjes së Grantit ose të rëna dakord sipas saj ose për të arritur objektivat e Projektit; dhe (B) nëse Granti i është dhënë një Përfituesi i cili nuk është Vend Anëtar, nuk ndikon materialisht ose nuk bie ndesh me kushtin financiar ose operimin e Përfituesit (ose ndonjë enti tjetër të tillë).

(h) *Anëtarësimi.* Vendi Anëtar: (i) është pezulluar nga anëtarësimi ose ka pushuar së qeni anëtar i IBRD-së ose i IDA-s; ose (ii) ka pushuar së qeni anëtar i Fondit Ndërkombëtar Monetar.

(i) *Kushti i Përfituesit.* Nëse Granti i është dhënë një Përfituesi i cili nuk është Vend Anëtar:

(i) Çdo veprim është ndërmarrë për zgjidhjen, shpërbërjen ose pezullimin e operacioneve të Përfituesit (ose ndonjë subjekt tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit);



(ii) Përfituesi (ose ndonjë subjekt tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka pushuar së ekzistuari në të njëjtën formë ligjore siç ka qenë në datën e Marrëveshjes së Grantit.

(iii) Sipas mendimit të Bankës Botërore, karakteri ligjor, pronësia ose kontrolli i Përfituesi (ose i ndonjë subjekti tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka ndryshuar nga ajo që ka qenë në datën e Marrëveshjes së Grantit në mënyrë të tillë që ndikon materialisht dhe bie ndesh me aftësinë e Përfituesit (ose ndonjë subjekti tjetër) për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të tij që lindin sipas Marrëveshjes së Grantit ose për të cilat është rënë dakord të; ose për të arritur objektivat e projektit.

(j) *Papranueshmëria*. IBRD ose IDA e ka shpallur Përfituesin (që nuk është Vend Anëtar) të papranueshëm për të marrë shuma nga ndonjë financim të bërë nga IBRD ose IDA ose ndryshe për të marrë pjesë në përgatitjen ose zbatimin në ndonjë projekt të financuar tërësisht ose pjesërisht nga IBRD ose IDA si rezultat i: (i) e një vendimi nga IBRD ose IDA se Përfituesi është përfshirë në praktika mashtruese, korruptive, shtrënguese ose komplotuese në lidhje me përdorimin e parave të ndonjë financimi të dhënë nga IBRD ose IDA; dhe/ose (ii) një deklaratë nga ndonjë financues tjetër se Përfituesi është i papranueshëm për të marrë shuma të ndonjë financimi të dhënë nga ky financues ose për të marrë pjesë në ndonjë mënyrë tjetër në përgatitjen dhe zbatimin e ndonjë projekti të financuar tërësisht ose pjesërisht nga ky financues si rezultat i vendimit nga ky financues që Përfituesi është angazhuar në praktika mashtruese, korruptive, shtrënguese ose komplotuese në lidhje me përdorimin e shumave të ndonjë financimi të dhënë nga ky financues.

(k) *Ngjarje Shtesë*. Ka ndodhur ndonjë ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit për qëllimet e këtij Seksioni ("Ngjarje Shtesë e Pezullimit").

Seksioni 4.03. *Anulimi nga Banka Botërore*. Banka Botërore duke njoftuar Përfituesin, mund ta ndërpresë të drejtën e Përfituesi për të bërë tërheqje në lidhje me një shumë të patërhequr të Grantit dhe ta anulojë këtë shumë, nëse ndodh ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme në lidhje me këtë shumë:

(a) *Pezullimi*. E drejta e Përfituesit që të bëjë tërheqje nga Llogaria e Grantit është pezulluar në lidhje me ndonjë shumë të Grantit për një periudhë të vazhduar prej tridhjetë ditësh.

(b) *Shumat e Pakërkuara*. Banka Botërore përcakton, pas konsultimeve me Përfituesin, se një shumë e Grantit nuk do të kërkohet për të financuar Shpenzimet e Pranueshme.

(c) *Mashtrimi dhe Korrupsioni*. Në çdo kohë Banka Botërore vendos në lidhje me ndonjë shumë financiare të Grantit se taktikat korruptive, mashtruese, komplotuese ose shtrënguese kanë qenë angazhuar nga përfaqësuesit e Përfituesi (ose Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vend Anëtar ose Përfituesi tjetër i shumave të Grantit), dhe Përfituesi (ose Vendi Anëtar ose ndonjë



Përfituesi tjetër i shumave të Grantit) nuk ka ndërmarrë veprime në kohët e duhura që të plotësojnë kërkesat e Bankës Botërore për të trajtuar këto praktika kur ato ndodhin.

(d) *Keqprokurimi*. Në çdo kohë, Banka Botërore: (i) përcakton se prokurimi i ndonjë kontrate që do të financohet nga shumat e Grantit nuk është në përputhje me procedurat e parashikuara ose që përmenden në Marrëveshjen e Grantit; dhe (ii) përcakton shumën e shpenzimeve sipas kësaj kontrate, e cila ndryshe do të ishte pranuar për financimin nga shumat e Grantit.

(e) *Data e Mbylljes*. Pas Datës së Mbylljes mbetet një shumë e patërhequr e Grantit.

Seksioni 4.04. Shumtat që i nënshtrohen Angazhimit të Veçantë të Paprekur. Asnjë anulim ose pezullim nga Banka Botërore nuk do të zbatohet për shumatat që i nënshtrohen ndonjë angazhimi të veçantë, përveç rastit kur parashikohet shprehimisht në Angazhimin e Veçantë.

Seksioni 4.05. *Rifinancimi i Grantit*

(a) Nëse Banka Botërore përcakton se një shumë e Grantit është përdorur në një mënyrë që nuk përputhet në dispozitat e Marrëveshjes së Grantit ose këto Kushte Standarde, Përfituesi, me njoftimin nga Banka Botërore për Përfituesin, menjëherë do t'ia rifinancojë këtë shumë Bankës Botërore. Ky përdorim jo në përputhje me dispozitat, do të përfshijë pa kufizim:

- (i) Përdorimin e kësaj shume për të kryer pagesën për një shpenzim që nuk është Shpenzim i Pranuar; ose
- (ii) (A) Përfshirje në praktika korruptive, mashtruese, komplotuese ose shtrënguese në lidhje me përdorimin e kësaj shume, ose (B) përdorimin e kësaj shume për të financuar një kontratë gjatë prokurimit ose ekzekutimit të së cilës në këto praktika janë përfshirë përfaqësuesit e Përfituesi (ose Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vendi Anëtar, ose ndonjë Përfituesi tjetër i kësaj shume të Grantit), në secilin rast kur Përfituesi (ose Vendi Anëtar, ose ndonjë Përfituesi tjetër) nuk ka ndërmarrë veprime në kohë dhe të përshtatshme që të plotësojnë kërkesat e Bankës Botërore për të trajtuar këto praktika ku ato ndodhin

(b) Përveç kur përcaktohet ndryshe nga Banka Botërore, Banka Botërore do të anulojë të gjitha shumatat e rifinancuara sipas këtij Seksioni.

Seksioni 4.06. *Efektiviteti i Vazhduar*. Pavarësisht nga çdo anulim, pezullim ose rifinancim sipas këtij Neni, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Grantit do të vazhdojnë të jenë në fuqi me efekt të plotë, me përjashtim të parashikimit në mënyrë specifike në këto Kushte Standarde.



NENI V

Zbatueshmëria; Arbitrazhi

Seksioni 5.01. *Zbatueshmëria*. Të drejtat dhe detyrimet e Përfituesit dhe Bankës Botërore sipas Marrëveshjes së Grantit do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me termat e tyre pavarësisht ligjit të ndonjë Shteti apo të ndonjë nënndarje politike për të kundërtën. As Përfituesi, as Banka Botërore nuk do të kenë të drejtë për ndonjë procedim sipas këtij Neni për të mbrojtur ndonjë pretendim që ndonjë dispozitë e këtyre Kushteve Standarde ose e Marrëveshjes së Grantit është e pavlefshme ose e pazbatueshme për shkak të ndonjë dispozitë të Neneve të Marrëveshjes së IBRD-së ose IDA-s, sipas rastit.

Seksioni 5.02. *Mosushtrimi i të Drejtave*. Asnjë vonesë në ushtrimin ose neglizhimin e ushtrimit të ndonjë të drejte, tagri apo rregullimi që i lind ndonjë pale sipas Marrëveshjes së Grantit me ndonjë mospërmbushje nuk do të dëmtojë këtë të drejtë, tagër apo rregullim ose nuk do të konceptohet se është heqje dorë e tyre ose pranim i heshtur i kësaj mospërmbushjeje. Asnjë veprim i kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërmbushje ose pranim në heshtje nga ana e saj të ndonjë mospërmbushjeje, nuk do të ndikojë apo dëmtojë ndonjë të drejtë, tagër ose rregullim të kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërmbushje tjetër ose pasuese.

Seksioni 5.03. *Arbitrazhi*. Çdo mosmarrëveshje midis palëve për Marrëveshjen e Grantit apo ndonjë pretendim të një pale kundër tjetrës që lind sipas Marrëveshjes së Grantit, e cila nuk është zgjidhur me marrëveshje ndërmjet palëve do t'i nënshtrohet Arbitrazhit nga një gjykatë arbitrazhi ("Gjykata e Arbitrazhit") siç parashikohet më poshtë.

(a) Palët në këtë arbitrazh do të jenë Banka Botërore nga njëra anë dhe Përfituesi nga ana tjetër.

(b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra të emëruar si më poshtë: (i) një arbitër do të emërohet nga Banka Botërore; (ii) arbitri i dytë do të emërohet nga Përfituesi; dhe (iii) arbitri i tretë ("Arbitri") do të emërohet me marrëveshje midis palëve ose nëse ato nuk bihen dakord, nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose nëse ky Kryetar nuk arrin ta bëjë emërimin, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Nëse secila palë nuk arrin të emërojë një arbitër, ky arbitër do të emërohet nga Arbitri. Nëse ndonjë arbitër i emëruar në përputhje me këtë Seksion, heq dorë, vdes ose bëhet i paaftë për të vepruar, do të emërohet një arbitër pasues në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në këtë Seksion për emërimin e arbitrit fillestar dhe ky pasues do të ketë të gjithë tagrat dhe detyrat e këtij arbitri fillestar.

(c) Një procedim arbitrazhi mund të kryhet sipas këtij Seksioni me njoftimin nga pala që e vë në lëvizje këtë procedim për palën tjetër. Ky njoftim do të përmbajë një deklaratë që parashikon natyrën e mosmarrëveshjes ose pretendimin që do të paraqitet tek arbitrazhi, natyrën e zgjidhjes që kërkohet dhe emrin e arbitrit të emëruar nga pala që nis këtë procedim. Brenda tridhjetë ditësh pas këtij njoftimi, pala tjetër do të njoftojë palën që fillon procedimin për emrin e arbitrit të emëruar nga kjo palë tjetër.



(d) Nëse brenda gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit që vë në lëvizje procedurën e arbitrazhit, palët nuk kanë rënë dakord për një arbitër, secila palë mund të kërkojë emërimin e Arbitrit siç parashikohet në paragrafin (b) të këtij Seksioni.

(e) Gjykata e Arbitrazhit do të mbledhet në atë kohë dhe në atë vend që do të përcaktohet nga Arbitri. Pas kësaj, Gjykata e Arbitrazhit do të përcaktojë ku dhe kur do të zhvillojë seancën.

(f) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë për të gjitha çështjet që lidhen me kompetencën e saj dhe duke iu nënshtruar dispozitave të këtij Seksioni dhe përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe, do të vendosë procedurën e saj. Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të jenë me votë shumice.

(g) Gjykata e Arbitrazhit do t'u sigurojë palëve një seancë të paanshme dhe do ta japë vendimin e saj me shkrim. Ky vendim mund të jepet edhe në mungesë. Një vendim i nënshkruar nga shumica e Gjykatës së Arbitrazhit do të përbëjë vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit. Një kopje e nënshkruar e vendimit do t'i transmetohet secilës palë. Çdo vendim i tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij Seksioni do të jetë i formës së prerë dhe detyrues për palët e Marrëveshjes së Grantit. Secila palë do të respektojë dhe do të jetë në përputhje me çdo vendim të dhënë nga Gjykata e Arbitrazhit në përputhje me dispozitat e këtij Seksioni.

(h) Palët do të caktojnë shumën e shpërblimit të arbitruessve dhe personave të tjerë që kërkojnë për kryerjen e procedurave të arbitrazhit. Nëse palët nuk bien dakord për këtë shumë përpara se të mbledhet Gjykata e Arbitrazhit, Gjykata e Arbitrazhit do ta caktojë këtë shumë siç do të jetë e arsyeshme sipas rrethanave. Secila palë do të marrë përsipër shpenzimet e saj me procedurën e arbitrazhit. Kostot e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen dhe përballohen midis palëve. Çdo çështje në lidhje me ndarjen e kostove të Gjykatës së Arbitrazhit apo procedurën për pagesën e këtyre kostove do të vendoset nga Gjykata e Arbitrazhit.

(i) Dispozitat për arbitrazhin të parashikuara në këtë Seksion do të jenë në vend të ndonjë procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve të Marrëveshjes së Grantit ose të ndonjë pretendimi të një pale të tillë kundër një pale tjetër të tillë që lind sipas Marrëveshjes së Grantit.

(j) Nëse brenda tridhjetë ditësh pasi tu jenë dërguar palëve kopjet e vendimit, nuk është zbatuar vendimi, secila palë: (i) mund të nisë një gjykim ose procedurë për zbatimin e vendimit në çdo gjykatë të juridiksionit kompetent kundër ndonjë pale tjetër; (ii) të zbatojë këtë vendim me ekzekutim; ose (iii) të ndjekë ndonjë rregullim tjetër të përshtatshëm kundër kësaj pale tjetër për zbatimin e vendimit dhe dispozitave të Marrëveshjes së Grantit. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse Përfituesi është Vend Anëtar, ky Seksion nuk do të autorizojë ndonjë fillim gjykimi ose zbatimi të vendimit kundër Përfituesit, me përjashtim të rastit kur kjo procedurë mund të jetë e disponueshme ndryshe nga arsyeja e dispozitave të këtij Seksioni.

(k) Dërgimi i një njoftimi apo procesi në lidhje me ndonjë procedurë sipas këtij Seksioni ose proces për të zbatuar ndonjë vendim të dhënë sipas këtij Seksioni mund të bëhet në mënyrën



e parashikuar në Seksionin 7.01. Palët e Marrëveshjes së Grantit heqin dorë nga çdo kërkesë dhe nga të gjitha kërkesat e tjera për kryerjen e ndonjë njoftimi apo procesi të tillë.

NENI VI

Hyrja në Fuqi; Përfundimi

Seksioni 6.01. *Hyrja në Fuqi*. Nëse nuk është specifikuar ndryshe në Marrëveshjen e Grantit, Marrëveshja e Grantit do të hyjë në fuqi në datën në të cilën është ekzekutuar nga të gjitha palët në Marrëveshjen e Grantit.

Seksioni 6.02. *Përfundimi*. Marrëveshja e Grantit dhe të gjitha detyrimet e palës pas saj do të ndërpriten menjëherë kur të gjitha detyrimet të jenë kryer plotësisht.

NENI VII

Të ndryshme

Seksioni 7.01. *Njoftimet dhe Kërkesat*. Çdo njoftim (ose kërkesë) sipas Marrëveshjes së Grantit do të jetë me shkrim. Ky njoftim (ose kërkesë) do të konsiderohet se është dhënë (ose është bërë) rregullisht kur të jetë dërguar dorazi ose me postë, teleks ose faks (ose, nëse lejohet sipas Marrëveshjes së Grantit, me mjete të tjera elektronike) palës së cilës ky njoftim (ose kërkesë) i drejtohet (Përfituesit) në adresën e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit për qëllimin (ose në një adresë tjetër të tillë që Përfituesi do të ketë përcaktuar duke njoftuar palën tjetër që e jep këtë njoftim ose që e bën këtë kërkesë) ("Adresa"). Dërgimet e kryera me transmetim me faks gjithashtu do të konfirmohen me postë.

Seksioni 7.02. *Veprimi në emër të Përfituesit*. Përfaqësuesi i përcaktuar nga Përfituesi në Marrëveshjen e Grantit për qëllimin e këtij Seksioni (ose çdo person i autorizuar me shkrim nga ky përfaqësues për qëllimin) ("Përfaqësuesi i Përfituesit") mund të ndërmarrë një veprim të kërkuar ose të lejuar që të kryhet sipas Marrëveshjes së Grantit dhe të ekzekutojë ndonjë dokument që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet sipas Marrëveshjes së Grantit në emër të Përfituesit.

Seksioni 7.03. *Provat e Autoritetit*. Përfituesi do t'i japë Bankës Botërore: (a) prova të mjaftueshme të autoritetit të përfaqësuesit të Përfituesit; (b) modelin e vërtetuar të nënshkrimit të këtij përfaqësuesi.

Seksioni 7.04. *Ekzekutimi në Kopje*. Marrëveshja e Grantit mund të ekzekutohet në disa kopje, ku secila do të jetë origjinale.

Seksioni 7.05. *Publikimi*. Banka Botërore mund ta publikojë Marrëveshjen e Grantit dhe çdo informacion që lidhet me Marrëveshjen e Grantit në përputhje me politikën e saj për aksesin në informacion, që është në fuqi në kohën e këtij publikimi.

**SHTOJCË****Përkufizimet**

1. “Ngjarje Shtesë e Pezullimit” do të thotë çdo ngjarje e pezullimit e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit për qëllimin e Seksionit 4.02 (k).
2. “Adresë” do të thotë Adresa e Përfituesi që përmendet në Seksionin 7.01, të cilit i drejtohen njoftimet dhe kërkesat sipas Marrëveshjes së Grantit.
3. “Marrësi” do të thotë pala të cilës i drejtohen njoftimet dhe kërkesat për qëllimin e Seksionit 7.01.
4. “Aplikim” do të thotë një aplikim i bërë nga Përfituesi sipas Seksionit 3.04 për tërheqjen e një shume të Grantit nga llogaria e Grantit ose për t’i kërkuar Bankës Botërore që të hyjë në një angazhim të veçantë në lidhje me shumën e Grantit.
5. “Gjykatë Arbitrazhi” do të thotë një gjykatë arbitrazhi e caktuar sipas Seksionit 5.03.
6. “Datë e Mbylljes” do të thotë data e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit (ose në një datë tjetër të mëvonshme që do ta përcaktojë Banka Botërore me njoftimin për Përfituesin) pas së cilës Banka Botërore, duke njoftuar Përfituesin, mund të ndërpresë të drejtën e Përfituesit për të tërhequr nga Llogaria e Grantit.
7. “Raporti i Përfundimit” do të thotë çdo raport që do të përgatitet dhe do t’i jepet Bankës Botërore sipas Seksionit 2.06 (b) (ii).
8. “Llogaria e Përcaktuar” do të thotë çdo llogari që përmendet në Seksionin 3.05 në të cilën Banka mund të depozitojë shumat e tërhequra nga Llogaria e Grantit si paradhënie për qëllimet e Projektit.
9. “Dollar”, “\$” dhe “USD” do të thotë monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
10. “Shpenzimet e Pranueshme” do të thotë një shpenzim, pagesa e të cilit plotëson kërkesat e Seksionit 3.06 dhe që për pasojë është i pranuar për financim nga shumat e Grantit.
11. “Pasqyrat Financiare” do të thotë pasqyrat financiare që do të mbahen për Projektin në përputhje me Seksionin 2.07.
12. “Grant” do të thotë Granti i parashikuar në Marrëveshjen e Grantit.



13. “Llogaria e Grantit” do të thotë llogaria e hapur nga Banka Botërore në librat e saj në emër të Përfituesit të cilit i kreditohet Granti në përputhje me Seksionin 3.01 (a).
14. “Marrëveshja e Grantit” do të thotë Marrëveshja e Grantit ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore që përcakton Grantin, siç kjo marrëveshje mund të ndryshohet herë pas here. Marrëveshja e Grantit përfshin këto kushte standarde siç aplikohen në Marrëveshjen e Grantit dhe të gjithë shtojcat, tabelat dhe marrëveshjet që plotësojnë Marrëveshjen e Grantit.
15. “IBRD” do të thotë Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.
16. “IDA” do të thotë Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim.
17. “Vend Anëtar” do të thotë anëtar i Bankës Botërore në territorin e të cilit kryhet Projekti apo ndonjë prej nënndarjeve politike apo administrative të anëtarit. Nëse Granti i jepet nga Banka Botërore ndonjë anëtar i tillë si palë e Marrëveshjes së Grantit, termi “Vend Anëtar” dhe “Përfitues” i referohen të njëjtit entitet.
18. “Projekt” do të thotë projekti i përshkruar në Marrëveshjen e Grantit për të cilin është dhënë Granti, ashtu siç mund të ndryshohet përshkrimi i këtij projekti herë pas here me anë të Marrëveshjes, ndërmjet Përfituesit dhe Bankës Botërore.
19. “Raporti i Projektit” do të thotë çdo raport për Projektin që do të përgatitet dhe do t'i dorëzohet Bankës Botërore për qëllimin e Seksionit 2.06 (b) (i).
20. “Përfitues” do të thotë pala e Marrëveshjes së Grantit të cilës i jepet Granti.
21. “Përfaqësues i Përfituesit” do të thotë përfaqësuesi që përmendet në Seksionin 7.02 i përcaktuar nga Përfituesi në Marrëveshjen e Grantit ose që autorizohet me shkrim nga ky përfaqësues për qëllimin e këtij Seksioni.
22. “Angazhim i Veçantë” do të thotë një angazhim i veçantë i marrë përsipër ose që do të merret përsipër nga Banka Botërore sipas Seksionit 3.03.
23. “Prova Mbështetëse” do të thotë provat dhe dokumentet që do t'i dorëzohen Bankës Botërore në përputhje me Seksionin 3.04 (b) në lidhje me një Aplikim.
24. “Taksat” përfshijnë taksat, tatimet, tarifat dhe pagesat e çdo natyre që do të jenë në fuqi në datën e Marrëveshjes së Grantit ose që do të vendosen pas asaj date.
25. “Arbitër” do të thotë arbitri i tretë i emëruar sipas Seksionit 5.03 (b).
26. “Banka Botërore” do të thotë: (a) IBRD nëse Granti jepet ose administrohet nga IBRD; (b) IDA nëse Granti jepet ose administrohet nga IDA; dhe (c) kolektivisht, IBRD dhe IDA nëse Granti jepet ose administrohet nga IBRD dhe IDA.

**VENDIM****Nr. 871, datë 30.10.2015**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 590, DATË 5.9.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E BANESAVE TË PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE TË VENDIT, TË SELIVE, REZIDENCave DHE OBJEKTEVE TË TJERA SHTETËRORE, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “c”, të pikës 1, të vendimit nr. 590, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas emërimit “... Ministrinë e Punëve të Jashtme...” shtohet emërtimi “... Prokurorinë e Përgjithshme...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 872, datë 30.10.2015**

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2016, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të shpenzimeve të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, për vitin 2016, në shumën 40 258 000 (dyzet milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1

PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2016

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Në lekë
1	Shpenzime për paga	22 722 000
2	Sigurime shoqërore	3 271 000
3	Shërbime e furnitura	13 000 000
4	Investime	1 265 000
	TOTALI	40 258 000

VENDIM**Nr. 873, datë 30.10.2015**

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “ROZAF” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “OBJEKTE TË AGJENCISË SË REZERVAVE TË SHTETIT, LABINOT, ELBASAN”, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Rozafa” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Objekte të Agjencisë së Rezervave të Shtetit, Labinot, Elbasan”, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, me sipërfaqe të përgjithshme 52613 (pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) m², nga të cilat sipas genplanit, përkatësisht, sipërfaqe nën objekt 13872.94 (trembëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e katër) m² dhe sipërfaqe funksionale 38740.06 (tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzet pikë zero gjashtë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 874, datë 30.10.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 592, DATË 10.9.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E
FONDIT NË MBËSHTETJE TË GRAVE
SIPËRMARRËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronjat “a”, “c”, “ç”, “d” e “dh”, 7 e 8, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 592, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “d”, e pikës 6, shfuqizohet.

2. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për menaxhimin e fondit që do të përdoret për subvencionimin e interesave të kredive dhe për të lidhur marrëveshje me qëllim disbursimin e Fondit në Mbështetje të Grave Sipërmarrëse, me institucionet e mikrokredisë, si:

a) Institucionet financiare jobankare;

b) Shoqëritë e kursim-kreditit;

c) Bankat e nivelit të dytë që ofrojnë mikrokredi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 875, datë 30.10.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 593, DATË 10.9.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E
FONDIT NË MBËSHTETJE TË
SIPËRMARRJEVE TË REJA
“START-UP””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronjat “a”, “c”, “ç”, “d” e “dh”, 7, pika 2, dhe 8, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Paragrafi i dytë, në pikën 4, të vendimit nr. 593, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet me këtë përmbajtje:



“Gëzojnë të drejtën për të përfituar nga kjo skemë të gjitha sipërmarrjet e reja që zhvillojnë veprimtari për një periudhë nga 0 (zero) deri në 2 (dy) vjet dhe janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 876, datë 30.10.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 758, DATË 15.9.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT, SI DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë

Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 758, datë 15.9.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 1 riformulohet me këtë përmbajtje:

“1. Përzgjedhja e katër anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, bëhet nga ministria përgjegjëse për ekonominë.”.

2. Pika 2 e vendimit, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë